FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 197

Tiranë – E enjte, 10 shtator 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 8, datë 3.9.2026	Për kushtet dhe procedurat për transferimin horizontal dhe vertikal brenda sistemit të AFP-së.....	19791
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 463, datë 1.9.2026	Për miratimin e formatit të aplikimit për akses dhe informacion në burimet gjenetike apo në informacionin e tyre dhe të formatit të certifikatës për akses në burimin gjenetik apo në informacionet përkatëse gjenetike.....	19793
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 884, datë 2.9.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	19797
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 885, datë 2.9.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.	19799
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 886, datë 2.9.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	19800
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 887, datë 2.9.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës.....	19801
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 888, datë 2.9.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 575, datë 25.5.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës"; urdhrit nr. 716, datë 10.7.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë"; urdhrit nr. 152, datë 13.2.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Republikës së Çekisë".....	19802

Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 43, datë 2.9.2026	Për disa ndryshime në rregulloren "Për veprimtarinë valutore".....	19803
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 44, datë 2.9.2026	Për disa ndryshime në rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave".....	19804
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 45, datë 2.9.2026	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga Banka ProCredit sh.a.....	19806
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nr. 281 (61-2025-2587), datë 15.6.2026	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Elvis Troqe.....	19807
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sadik Sadiku.....	19807

UDHËZIM
Nr. 8, datë 3.9.2026

PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR TRANSFERIMIN HORIZONTAL DHE VERTIKAL BRENDA SISTEMIT TË AFP-së

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 16 dhe 20, pika 4, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1
Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim përcakton kushtet dhe procedurat e transferimit të nxënësve brenda sistemit të arsimit dhe formimit profesional (AFP), ku përfshihen:

a) transferimin vertikal, nga një nivel i kualifikimeve profesionale në një nivel më të lartë;

b) transferimin horizontal, nga një kualifikim profesional në një tjetër brenda të njëjtit nivel;

c) transferimin e nxënësve shqiptarë dhe të huaj nga shkolla profesionale jashtë Republikës së Shqipërisë, për t'i vijuar studimet e ndërmjetme në institucionet e arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, sipas procedurave të njëvlershmërisë të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen nga të gjithë ofruesit publikë dhe jopublikë të arsimit dhe formimit profesional që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Transferimi vertikal brenda sistemit të AFP-së

1. Nxënësi që ka përfunduar me sukses një kualifikim profesional në një nivel të caktuar të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), ka të drejtë të vijojë një kualifikim profesional në nivelin më të lartë pasues.

2. Nxënësi që përfundon me sukses një kualifikim profesional të nivelit 4 të KSHK-së mund të vijojë kualifikimet profesionale të mëtejshme në nivelin 5 të KSHK-së (pas të mesme) dhe në nivelin 6 të KSHK (bachelor), sipas rrugëve të progresionit të përcaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe në përputhje me praktikat e Bashkimit Evropian për mobilitet dhe zhvillim profesional.

3. Nxënësi konsiderohet që e ka përfunduar me sukses një nivel të caktuar të kualifikimit profesional nëse është pajisur me dokumentet e certifikimit në arsimin profesional, sipas akteve nënligjore në fuqi.

4. Për t'u regjistruar në një nivel më të lartë të kualifikimit profesional, nxënësi duhet të jetë pajisur me dokumentet e certifikimit në arsimin profesional të kualifikimit profesional të nivelit paraardhës.

5. Transferimi i nxënësit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë të Arsimit Profesional (AP), bëhet me kërkesë nga nxënësi ose prindi/kujdestari ligjor i tij, e cila shoqërohet me dokumentet e certifikimit të nivelit paraardhës, si dhe çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kritereve të veçanta (nëse ka).

Neni 3
Transferimi horizontal brenda sistemit të AFP-së

1. Nëse nxënësi dëshiron të ndërrojë kualifikimin profesional, kjo mund të bëhet vetëm gjatë vitit të parë të kualifikimit profesional, por jo më vonë se dy muaj nga dita e fillimit të vitit shkollor, duke përjashtuar klasën e 10-të.

2. Përzgjedhja e kualifikimit profesional ose ndërrimi i tij bëhet me kërkesë nga nxënësi ose prindi/kujdestari ligjor i tij, si dhe shoqërohet me dokumentacionin tjetër që vërteton plotësimin e kritereve të veçanta (nëse ka).

Neni 4
Transferimi i nxënësve shqiptarë dhe të huaj nga shkollat profesionale jashtë shtetit në shkollat profesionale në Shqipëri

1. Nxënësit shqiptarë dhe të huaj, që kanë ndjekur studimet në shkolla profesionale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtë të kërkojnë transferimin e tyre në vitet e ndërmjetme të kualifikimeve profesionale në shkollat e arsimit të mesëm profesional në Shqipëri, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Nxënësit shqiptarë dhe/ose të huaj, të cilët transferojnë studimet e tyre nga shkollat

profesionale jashtë vendit për t'i vijuar ato në vitet e ndërmjetme të arsimit profesional, i nënshtrohen procesit të njehsimit të studimeve të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Procedura e njehsimit të studimeve, e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, kryhet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), mbi bazën e programit mësimor të ndjekur dhe rezultateve të arritura, vjetore dhe/ose të vazhduara, të lëshuara nga institucioni arsimor përkatës jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të jetë i pajisur me vulë apostile ose me legalizim konsullor, për vendet që nuk aplikojnë vulën apostile, si dhe i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Procedura e njehsimit të studimeve nis me aplikimin *online* nëpërmjet platformës *e-albania* dhe ngarkon dokumentacionin e kërkuar, nga prindi/kujdestari ligjor i tij. Pas përfundimit të aplikimit në platformën elektronike *e-albania*, aplikuesi dorëzon në AKAFPK, në rrugë postare, dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve në pikën 3 të këtij neni, shoqëruar me kërkesën me shkrim për njehsimin e studimeve.

5. AKAFPK-ja, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, përcakton përputhshmërinë e periudhave të ndjekura, të kompetencave të fituara dhe të lëndëve/ programeve të kryera, si dhe detyrimet arsimore që nxënësi duhet të përmbushë për t'u integruar në vitin përkatës të arsimit profesional në Republikën e Shqipërisë.

6. Nxënësit shqiptarë dhe/ose të huaj, kanë të drejtë t'i transferojnë studimet e tyre në vitet e ndërmjetme në shkollat e arsimit të mesëm profesional në Shqipëri, në vitin shkollor aktual, vetëm gjatë dy muajve të parë nga data e fillimit të vitit shkollor.

7. Kur afati i përcaktuar në pikën 6 të këtij neni është tejkaluar, nxënësi vijon studimet në vitin shkollor pasardhës, duke respektuar kriterin e moshës, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar.

8. Vijimi i studimeve brenda vitit shkollor aktual lejohet vetëm nëse periudha nga ndërprerja e studimeve jashtë shtetit deri në momentin e njehsimit dhe regjistrimit në shkollat e arsimit profesional në Shqipëri nuk është më shumë se dy muaj, sipas dokumentacionit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

9. AKAFPK-ja krahason planin mësimor të paraqitur nga nxënësi me planin mësimor korrespondues të kualifikimit profesional ku kërkohet transferimi dhe përpilon dokumentin zyrtar të njehsimit.

10. Gjatë njehsimit të rezultateve të arritura në studimet jashtë vendit, AKAFPK-ja i referohet akteve zyrtare të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, mbi sistemin e vlerësimit/notave të vendeve të huaja, krahasuar me sistemin shqiptar të vlerësimit/notave.

11. AKAFPK-ja lëshon dokumentin zyrtar të njehsimit, brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të dokumentacionit të plotë.

12. Dokumenti zyrtar i njehsimit, i lëshuar nga AKAFPK-ja, është i detyrueshëm për shkollën e mesme profesionale për efekt të regjistrimit dhe vijimit të mëtejshëm të shkollimit të nxënësit.

13. Për nxënësit shqiptarë dhe/ose të huaj, që kanë ndjekur studimet në një shkollë të mesme profesionale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe dëshirojnë të transferohen në shkollat profesionale në Shqipëri, duhet të plotësojnë planin mësimor sipas strukturave të AP-së, me të drejtën për të dhënë deri në 6 (gjashtë) provime në total, për lëndë, module (praktikë profesionale) dhe/apo provime përfundimtare të nivelit përkatës, përfshirë këtu edhe lëndët e mbartura nga studimet e ndjekura jashtë vendit.

14. Nëse në dokumentin zyrtar të lëshuar nga AKAFPK-ja, janë përcaktuar deri në 6 (gjashtë) lëndë, module (praktikë profesionale) dhe/apo provime përfundimtare të nivelit përkatës, nxënësi regjistrohet në të njëjtin vit dhe nivel të kualifikimit profesional.

15. Nëse në dokumentin zyrtar të lëshuar nga AKAFPK-ja, janë përcaktuar më shumë se 6 (gjashtë) lëndë, module (praktikë profesionale) dhe/apo provime përfundimtare të nivelit përkatës, nxënësi nuk regjistrohet në të njëjtin vit dhe nivel të kualifikimit profesional. Në këtë rast nxënësi mund të regjistrohet në klasën përkatëse të vitit paraardhës.

16. Shkolla profesionale është e detyruar të zbatojë dokumentin zyrtar të lëshuar nga AKAFPK-ja dhe të marrë masat për realizimin e detyrimeve shtesë që i caktohen nxënësit, sipas kërkesave të standardeve kombëtare të kualifikimeve profesionale.

Neni 5
Transferimi për kandidatët që certifikohen përmes procesit të njohjes së të nxënit të mëparshëm

1. Kandidatët që pajisen me certifikatë kualifikimi të nivelit 4 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, të përfituar përmes procesit të Njohjes së të Nxënit të Mëparshëm, kanë të drejtë të ndjekin programe plotësuese për përvetësimin e lëndëve të përgjithshme të arsimit të mesëm.

2. Programet plotësuese në formën e kurseve urë, organizohen nga institucionet e arsimit dhe formimit profesional ose të arsimit parauniversitar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

3. Kandidatët që përfundojnë me sukses programet plotësuese dhe plotësojnë kërkesat përkatëse fitojnë të drejtën të regjistrohen dhe të marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6
Dispozita përfundimtare

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe ofruesit publikë dhe jopublikë të AFP-së.

2. Udhëzimi nr. 38, datë 21.11.2018, "Për kushtet dhe procedurat e transferimit horizontal dhe vertikal brenda sistemit të arsimit dhe formimit profesional (AFP)", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

URDHËR
Nr. 463, datë 1.9.2026

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË APLIKIMIT PËR AKSES DHE INFORMACION NË BURIMET GJENETIKE APO NË INFORMACIONIN E TYRE DHE TË FORMATIT TË CERTIFIKATËS PËR AKSES NË BURIMIN GJENETIK APO NË INFORMACIONET PËRKATËSE GJENETIKE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 44/7, të pikës 4, të nenit 44/8, dhe të pikës 4, të nenit 44/4, të ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit të aplikimit për akses dhe informacion në burimet gjenetike apo informacionin e tyre, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e formatit të certifikatës për akses në burimin gjenetik apo në informacionet përkatëse gjenetike, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet drejtoria përgjegjëse për biodiversitetin për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj

Shtojca 1

FORMATI I APLIKIMIT PËR AKSES DHE INFORMACION NË BURIMET GJENETIKE APO INFORMACIONIN E TYRE

KËRKESË[1]
PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË PËR AKSES NË BURIME GJENETIKE OSE INFORMACIONIN RRETH TYRE

Drejtuar: _____

I. TË DHËNAT E PËRDORUESIT (*kërkuesit*)
- Emri i subjektit/individit: _____
- NIPT-i/nr. identifikimi: _____
- Adresa: _____
- Shtetësia (nëse aplikohet) _____
- Përfaqësuesi ligjor: _____
- Kontakt (tel./*email*): _____

II. LLOJI I KËRKESËS
- Akses në burim gjenetik □
- Akses në informacion mbi burimin gjenetik □
- Akses në njohuri tradicionale □
- Kombinim i tyre □

III. PËRSHKRIMI I BURIMIT GJENETIK – *Llojet e produkteve të propozuara për përdorimin të materialeve të burimeve gjenetike*
- Kategoria (florë/faunë/mikroorganizëm): _____
- Lloji/specia: _____
- Kodi unik dhe kodi GBIF _____
- Statusi i mbrojtjes (nëse është i njohur): _____
- Vendndodhja e burimit: *in-situ* □ *ex-situ* □

(përcakto zonën gjeografike, adresa) _____
- Sasia/volumi i kërkuar: _____
- Burim për ushqim e bujqësi: _____
- Koleksion i regjistruar: _____

IV. QËLLIMI I AKSESIT
- Kërkim shkencor (*jo tregtar*) □
- Zhvillim teknologjik (*tregtar*) □
- Përdorim tregtar □
- Qëllime të tjera: _____
- Financim i veprimtarisë: _____
- Skema dhe financuesi: _____

Përshkrimi i detajuar i përdorimit:

_____
_____
_____

V. METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË
- Përshkrimi i metodës së marrjes: _____
- Veprimtaritë që do të zhvillohen: _____
- Kohëzgjatja/periudha e planifikuar: _____

VI. TË DHËNA MBI PRONARIN/PRONARËT E MATERIALIT
- Autoriteti publik _____
- Mbajtësi i koleksionit (*ex-situ*) _____

[1]Informacioni dhe të dhënat e kësaj kërkese, që pasqyrohen edhe në certifikatë, publikohet nga ministria pranë Mekanizmit të Shkëmbimit të Informacionit për Aksesin dhe Ndarjen e Përfitimeve *(ABS Clearing - House)*, duke respektuar konfidencialitetin e informacionit tregtar apo industrial.

- Numri i regjistrimit: _____
- Emri i subjektit/individit: _____
- NIPT-i/nr. identifikimi: _____
- Adresa: _____
- Shtetësia (nëse aplikohet) _____
- Përfaqësuesi ligjor: _____
- Kontakt (tel./*email*): _____

VII. TRANSFERIMI DHE PËRDORIMI NGA PALË TË TRETA

- A parashikohet transferim? Po□ Jo □
- Nëse po, specifiko: _____
- Identifikimi i palëve të treta: _____
- Transferimi i informacionit: _____

VIII. NDARJA E PËRFITIMEVE *(BENEFIT-SHARING)*

(në përputhje me legjislacionin për biodiversitetin)

Lloji i përfitimeve: monetare □ jo monetare □

- Aplikime pasuese, tregtim: _____
- Përshkrimi i marrëveshjes së propozuar:

_____

IX. MASAT PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT

- Masat për minimizimin e ndikimit: _____
- Masat për ruajtjen e burimit: _____

X. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Bashkëlidhen:

- Dokument identifikimi/ekstrakt QKB-je □
- Projektpropozimi/studimi □
- Konfirmimi i marrjes së pëlqimit paraprak nga komuniteti/pronari/pronarët e materialit (PIC) □
- Kushtet e pranuara reciprokisht (MAT) □
- Marrëveshja e transferimit të materialit (MTA) □
- Certifikata e pajtueshmërisë (IRCC), nëse ka □
- Të tjera: _____

XI. DEKLARIMI I APLIKANTIT

Deklaroj se:

- të dhënat e paraqitura janë të sakta;
- do të respektoj kushtet e certifikatës dhe legjislacionin në fuqi për biodiversitetin;
- do të raportoj dhe bashkëpunoj me autoritetet kompetente;
- veprimtaria e përdorimit të materialit gjenetik do të jetë në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe nuk ka ndikim negativ në mjedis.
- do të ushtroj kujdesin e duhur *(due diligence)* për të vërtetuar se burimet gjenetike dhe njohuritë tradicionale të lidhura me to janë aksesuar në përputhje me legjislacionin ose kërkesat rregullatore të zbatueshme, dhe se përfitimet ndahen sipas kushteve të pranuara reciprokisht;
- do të ruaj informacionin e rëndësishëm për aksesin dhe ndarjen e përfitimeve për 20 (njëzet) vjet pas përfundimit të periudhës së përdorimit;
- do t'u kërkoj, mbaj dhe transferoj përdoruesve pasues informacionin dhe dokumentacionin e parashikuar në legjislacionin në fuqi;
- do të ndërpres përdorimin nëse informacioni në zotërimin tim rezulton i pamjaftueshëm ose mbeten paqartësi mbi ligjshmërinë e aksesit dhe të përdorimit, dhe nuk arrij të siguroj lejen e aksesit dhe kushtet e pranuara reciprokisht.

Data ___._____._____

KËRKUESI

_____

Emri, mbiemri
firma/vula

R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
MINISTRIA E MJEDISIT

Shtojca 2

CERTIFIKATË[2]
PËR AKSES NË BURIMIN GJENETIK
APO NË INFORMACIONET PËRKATËSE GJENETIKE

Numri i Certifikatës _____ Identifikuesi unik 000000000

Data e lëshimit ____.____._____ Afati i vlefshmërisë ____.____._____

LLOJI I AKSESIT

Akses në burim gjenetik □ **Akses në informacion** □ **Akses në njohuri tradicionale**□

1	Emri i përdoruesit/ institucioni/organizata	_____
2	Adresa	_____
3	Kontakt (tel., *email*)	_____
4	Shtetësia	_____
5	Përshkrimi i burimit gjenetik	-Kategoria (florë/faunë/mikroorganizëm): _____ -Lloji/specia: _____ -Kodi unik dhe kodi GBIF _____ -Statusi i mbrojtjes _____
6	Vendndodhja e burimit *(zona gjeografike, adresa – emri i koleksionit)*	*in-situ* □ *ex-situ* □ _____
7	Qëllimi i aksesit (përdorimi)	Tregtar □ zhvillim teknologjik □ kërkim shkencor □
8	Sasia	_____
9	Konfirmimi i marrjes së pëlqimit paraprak *numri, data*	_____
10	Transferim dhe përdorim nga palë të treta	Po □ Jo □
11	Kushtet e pranuara reciprokisht (MAT) *numri i dokumentit, data*	_____
12	Lloji i përfitimeve	monetar □ jo monetar □

[2] Kjo certifikatë publikohet nga ministria pranë Mekanizmit të Shkëmbimit të Informacionit për Aksesin dhe Ndarjen e Përfitimeve *(ABS Clearing – House)*, dhe merr statusin e certifikatës së pajtueshmërisë të njohur ndërkombëtarish sipas nenit 17, pika 2, të Protokollit të Nagoyas.

13	Pronari i materialit/mbajtësi i koleksionit *institucioni/subjekti/individi*	_____
14	Ofruesi i burimit gjenetik	_____
15	Personi ose subjekti të cilit i është dhënë pëlqimi paraprak, i informuar nga komuniteti	_____
16	Kushtet specifike të përdorimit	_____
17	Periodiciteti i vetëdeklarimit të të dhënave të përdorimit	_____
18	Vërtetim se janë vendosur kushtet e pranuara reciprokisht	_____
19	Vërtetim se është marrë pëlqimi paraprak i informuar nga komuniteti	_____
20	Kufizimet dhe detyrimet lidhur me përdorimin, aplikimet pasuese dhe tregtimin	_____

Autoriteti lëshues

_____

Nënshkrimi/vula

URDHËR
Nr. 884, datë 2.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë**	**Ndarja administrative e nivelit të tretë***
Aragón	Huesca	Boltaña*
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Castilla y León	Segovia	Segovia*
Castilla - La Mancha	Toledo	Galvez*
Castilla - La Mancha	Toledo	Toledo*
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Comunidad Foral de Navarra	Navarra	Ochagavia*
Extremadura	Badajoz	Don Benito*
Extremadura	**Cáceres**	**Logrosan (Zorita)***
Extremadura	Cáceres	Navalmoral de la Mata*
País Vasco	Araba/Álava	Araba-Alava*
País Vasco	Gipuzkoa	Gipuzkoa*
Principado de Asturias	Asturias	Tineo*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*
Illes Balears	Illes Balears	Menorca*
Galicia	A Coruña	Ferrol*
Galicia	A Coruña	A Barcala*
Galicia	Lugo	Chantada*
Galicia	Lugo	Meira*
Galicia	**Pontevedra**	**Deza***
La Rioja	La Rioja	Alfaro*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga

vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e

Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 876, datë 31.8.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 885, datë 2.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
2.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Ludwigslust-Land*
3.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritz*
4.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*
5.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
6.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Peenetal/Loitz*
7.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Miltzow*
8.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Recknitz-Trebeltal*
9.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Goldberg-Mildenitz*
10.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Bützow-Land*
11.	Brandenburg	Elbe-Elster	Uebigau-Wahrenbrück*
12.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Mecklenburgische Kleinseenplatte*
13.	Bayern	Regensburg	Sünching*
14.	Niedersachsen	Friesland	Wangerland*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 788, datë 30.7.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me

patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 886, datë 2.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Baden-Württemberg	Bodenseekreis	Überlingen*
Baden-Württemberg	Breisgau-Hochschwarzwald	Hexental*
Baden-Württemberg	Breisgau-Hochschwarzwald	Müllheim-Badenweiler*
Baden-Württemberg	Breisgau-Hochschwarzwald	St. Peter*
Baden-Württemberg	Enzkreis	Heckengäu*
Baden-Württemberg	Emmendingen	Elzach*
Baden-Württemberg	Karlsruhe	Pfinztal*
Baden-Württemberg	Ortenaukreis	Gengenbach*
Baden-Württemberg	Schwarzwald-Baar-Kreis	Raumschaft Triberg*
Baden-Württemberg	Waldshut	Waldshut-Tiengen*
Hessen	Bergstraße	Wald-Michelbach*
Hessen	Fulda	Ehrenberg (Rhön)*
Hessen	Odenwaldkreis	Sensbachtal*
Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Kalbe (Milde)*
Saarland	Merzig-Wadern	Weiskirchen*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme

në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 633, datë 12.6.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 887, datë 2.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E FRANCËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr.

10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Maine-et-Loire*	-	-

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 888, datë 2.9.2026

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 575, DATË 25.5.2026, "PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HOLANDËS"; URDHRIT NR. 716, DATË 10.7.2026, "PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË"; URDHRIT NR. 152, DATË 13.2.2026, "PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E REPUBLIKËS SË ÇEKISË"

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikën 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e:

- Urdhrit nr. 575, datë 25.5.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me

patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës";

- Urdhrit nr. 716, datë 10.7.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë";

- Urdhrit nr. 152, datë 13.2.2026 "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Republikës së Çekisë".

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 43, datë 2.9.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR VEPRIMTARINË VALUTORE"

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "c", të nenit 43 dhe shkronjave "d" dhe "dh", të pikës 3, të nenit 60, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për veprimtarinë valutore", miratuar me vendimin nr. 70, datë 30.9.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. përmbajtja e pikës 1, shkronja "c", ndryshohet si më poshtë:

"c) ligjin nr. 62/2020, datë 14.5.2020, "Për tregjet e kapitalit";";

ii. përmbajtja e pikave 3 dhe 4 ndryshohet si më poshtë:

"3. "Rezident" – është çdo person fizik, person juridik ose njësi institucionale që ka qendrën e interesit ekonomik në territorin e Republikës së Shqipërisë, zakonisht për një periudhë jo më të shkurtër se 12 (dymbëdhjetë) muaj, sipas ndarjeve të mëposhtme:

a) Personat fizikë – Personi fizik konsiderohet rezident kur:

i. banon zakonisht në Republikën e Shqipërisë dhe/ose ushtron aty veprimtari ekonomike në mënyrë të qëndrueshme,

ii. nuk ndryshon rezidencën jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç se për arsye studimi, trajtimi shëndetësor, shërbimi të përkohshëm apo udhëtimi jashtë vendit;

b) Personat juridikë dhe njësitë institucionale – Një person juridik ose njësi institucionale konsiderohet rezident(e) kur:

i. është i(e) regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, ose

ii. ka vendin e menaxhimit efektiv apo qendrën e operacioneve kryesore në Republikën e Shqipërisë;

Për qëllime të kësaj rregulloreje, "njësi institucionale" nënkupton çdo entitet ekonomik që ka kapacitet të zotërojë asete, të marrë përsipër detyrime dhe të kryejë transaksione në emër të vet;

c) Degët dhe zyrat e përfaqësimit, ku:

i. degët e jorezidentëve në Republikën e Shqipërisë trajtohen si njësi rezidente,

ii. degët e rezidentëve jashtë Republikës së Shqipërisë trajtohen si njësi jorezidente;

d) Sektori publik jashtë vendit dhe organizatat ndërkombëtare, ku:

i. njësitë diplomatike/konsullore dhe kontingjentet ushtarake të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, konsiderohen rezidentë të Republikës së Shqipërisë,

ii. organizatat ndërkombëtare të vendosura në Republikën e Shqipërisë konsiderohen jorezidente dhe personeli i huaj i akreditуar konsiderohet jorezident;

e) Njësitë jofitimprurëse (Non-Profit Institutions Serving Households - NPISH), entitetet me qëllim të posaçëm (Special Purpose Entities - SPE) dhe struktura të ngjashme, ku:

i. njësitë jofitimprurëse konsiderohen rezidente kur ushtrojnë veprimtarinë e tyre kryesisht në territorin e Republikës së Shqipërisë,

ii. entitetet me qëllim të posaçëm (SPE), shoqëritë zotëruese, fondet apo subjekte të ngjashme klasifikohen sipas vendit të regjistrimit ose të menaxhimit efektiv.

Klasifikimi i rezidencës për zbatimin e kësaj rregulloreje bazohet në parimin e qendrës së interesit ekonomik dhe

interpretohet në përputhje me Manualin e Bilancit të Pagesave (Balance of Payments Manual 6th Edition - BPM6).

4. Të gjithë personat apo njësitë e tjera, që nuk përfshihen në kategorinë "rezidentë" sipas përcaktimeve të paragrafit 3 të këtij neni, do të konsiderohen si "jorezidentë".";

b) Në nenin 7, pika 3, shfuqizohet togfjalëshi "*në përputhje me dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje*";

c) Në nenin 11, pika 1, togfjalëshi "*për shumat mbi 1 milion lekë ose kundërvleftën e tyre në valutë*", zëvendësohet me togfjalëshin ", *për shumat mbi 10 000 (dhjetë mijë) euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera,*";

d) Përmbajtja e nenit 14 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Neni 14
Detyrimet e subjekteve për dokumentacionin

1. Dokumentacioni i kërkuar në këtë rregullore paraqitet te subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe ruhet prej tij, sipas parashikimeve të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.";

e) Kreu VI "DISPOZITA PËRFUNDIMTARE" dhe neni 15, shfuqizohen;

f) Shtojca nr. 1 shfuqizohet.

2. Ngarkohen subjektet e rregullores me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 31 tetor 2026.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 44, datë 2.9.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR KRAHASUESHMËRINË E TARIFAVE TË LIDHURA ME LLOGARITË E PAGESAVE DHE PËR SHËRBIMIN E TRANSFERIMIT TË LLOGARIVE TË PAGESAVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja "e", dhe të neneve 124 dhe 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave"; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 21.12.2022, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në fund të shkronjës "b", hiqet togfjalëshi "*si dhe*";

ii. pas shkronjës "c", shtohet shkronja "d" me përmbajtjen e mëposhtme:

"d) përcaktimi i rregullave mbi transparencën e tarifave për këmbimin e monedhës përkundrejt lekut, për pagesat kombëtare dhe pagesat ndërkufitare me shtetet e Bashkimit Evropian";

b) Pas nenit 18, shtohet kreu V dhe nenet 18/1, 18/2 dhe 18/3, si pjesë përbërëse e kreut V, me përmbajtjen e mëposhtme:

"KREU V
KËRKESA MBI TRANSPARENCËN E TARIFAVE PËR KËMBIMIN E MONEDHËS PËRKUNDREJT LEKUT, PËR PAGESAT KOMBËTARE DHE PAGESAT NDËRKUFITARE ME SHTETET E BASHKIMIT EVROPIAN

Neni 18/1
Tarifat e këmbimit të monedhës të lidhura me transaksionet me kartë

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe palët që ofrojnë shërbime të këmbimit të monedhës në një ATM ose në pikën e shitjes (POS), siç përcaktohet në nenin 52, pika 2, të ligjit "Për shërbimet e pagesave", lidhur me kërkesat e informacionit mbi tarifat e këmbimit të monedhës dhe kursin e zbatueshëm të këmbimit, siç përcaktohet në nenin 38, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", nenin 45, shkronja "c", dhe në nenin 52, pikat 2 dhe 3, të ligjit "Për shërbimet e pagesave", duhet të shprehin tarifat totale të këmbimit të monedhës, si përqindje shtesë (mark-up) mbi kursin e këmbimit më të fundit të disponueshëm, të publikuar nga Banka e Shqipërisë. Kjo vlerë në përqindje (mark-up) duhet t'i njoftohet paguesit para inicimit të transaksionit të pagesës.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave, gjithashtu, duhet të publikojnë mark-up e referuar në pikën 1 të këtij neni, në një mënyrë që të jetë e kuptueshme, lehtësisht e aksesueshme, e vendosur në një platformë elektronike gjerësisht të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme.

3. Përveç informacionit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, një palë që ofron shërbimin e këmbimit të monedhës në një ATM ose në pikën e shitjes (POS) duhet t'i sigurojë paguesit informacionin e mëposhtëm, para inicimit të transaksionit të pagesës:

a) shumën që do t'i paguhet përfituesit në monedhën e përdorur nga përfituesi;

b) shumën që do të paguhet nga paguesi në monedhën e llogarisë së paguesit.

4. Një palë që ofron shërbimin e këmbimit të monedhës në një ATM ose në pikën e shitjes (POS) duhet të shfaqë qartë informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, në ATM ose në pikën e shitjes (POS).

Përpara inicimit të transaksionit të pagesës, ajo palë duhet, gjithashtu, të informojë paguesin mbi mundësinë e kryerjes së pagesës në monedhën e përdorur nga përfituesi dhe kryerjen në vijim, të këmbimit të monedhës nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit.

Informacioni i parashikuar në pikat 1 dhe 3 të këtij neni duhet, gjithashtu, t'i vihet në dispozicion paguesit me një mjet të qëndrueshëm komunikimi, pas inicimit të transaksionit të pagesës.

5. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit duhet t'i dërgojë paguesit, pa vonesa të panevojshme, një mesazh elektronik me informacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, për çdo kartë pagese që i është lëshuar paguesit prej tij dhe që është e lidhur me të njëjtën llogari, pasi ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit të ketë marrë një urdhër pagese për tërheqje fondesh në një ATM, ose për një pagesë në pikën e shitjes (POS), e cila është e denominuar në Lek, monedhë e ndryshme nga monedha e llogarisë së paguesit.

Pavarësisht sa parashikohet në këtë pikë, një mesazh i tillë duhet të dërgohet një herë në muaj, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit merr një urdhër pagese të denominuar në Lek, nga paguesi.

6. Ofruesi i shërbimeve të pagesave dakordëson me përdoruesin e shërbimeve të pagesave mbi kanalin ose kanalet e komunikimit elektronik gjerësisht të disponueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm, përmes të cilave ofruesi i shërbimeve të pagesave do të dërgojë mesazhet elektronike të parashikuara në pikën 5 të këtij neni.

Ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet t'u ofrojë përdoruesve të shërbimeve të pagesave mundësinë për të zgjedhur të mos marrin mesazhet elektronike të parashikuara në pikën 5 të këtij neni.

Kur përdoruesi i shërbimeve të pagesave nuk është konsumator, ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe përdoruesi i shërbimeve të pagesave mund të bien dakord që pikat 5 dhe 6 të këtij neni të mos zbatohen tërësisht ose pjesërisht.

7. Informacioni i parashikuar në këtë nen duhet të ofrohet pa pagesë, si dhe në një mënyrë neutrale dhe të plotë.

Neni 18/2
Tarifat e këmbimit të monedhës të lidhura me transfertat e kreditit

1. Kur shërbimi i këmbimit të monedhës ofrohet nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit në lidhje me një transfertë krediti, siç përcaktohet në nenin 5, pika 48, të ligjit "Për shërbimet e pagesave", e cila iniciohet direkt nëpërmjet internetit (online), duke përdorur faqen e internetit ose aplikacionin mobile banking të ofruesit të shërbimeve të pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave, në përputhje me nenin 38, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe nenin 45, shkronja "c", të atij ligji, duhet të informojë paguesin mbi tarifat e përllogaritura për shërbimin e këmbimit të monedhës përkundrejt lekut, në lidhje me transfertën e kreditit, në një mënyrë të qartë, neutrale dhe të plotë, para inicimit të transaksionit të pagesës.

2. Para inicimit të transaksionit të pagesës, ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet t'i komunikojë paguesit shumën totale të transfertës së kreditit të përllogaritur në monedhën e llogarisë së paguesit, duke përfshirë çdo tarifë të transaksionit dhe çdo tarifë të këmbimit të monedhës, në një mënyrë të qartë, neutrale dhe të plotë. Ofruesi i shërbimeve të pagesave, gjithashtu, duhet të komunikojë shumën e përllogaritur që do t'i transferohet përfituesit në monedhën e përdorur nga përfituesi.

Neni 18/3

Masat për lehtësimin e automatizimit të pagesave

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave, kur është e zbatueshme, duhet t'i komunikojë përdoruesit të shërbimeve të pagesave IBAN-in e përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe BIC-un e ofruesit të shërbimeve të pagesave, siç parashikohet në rregulloren 26/2022, "Për strukturën dhe përdorimin e numrit ndërkombëtar të llogarisë së pagesës" dhe në rregulloren 21/2024, "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në euro", e ndryshuar.

Kur është e zbatueshme, ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet të tregojë IBAN-in e përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe BIC-un e ofruesit të shërbimeve të pagesave në ekstraktin e gjendjes së llogarisë ose në një aneks të saj.

Ofruesi i shërbimeve të pagesave i vë në dispozicion përdoruesit të shërbimeve të pagesave informacionin e kërkuar sipas kësaj pike, pa pagesë.

2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të aplikojë tarifa shtesë, përveç atyre të aplikuara në përputhje me nenin 4/1, pika 1, të rregullores 21/2024, "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në euro", e ndryshuar, ndaj përdoruesit të shërbimeve të pagesave, kur ky i fundit i kërkon ofruesit të shërbimeve të pagesave të ekzekutojë një pagesë SEPA pa komunikuar IBAN-in dhe BIC-un përkatës për llogarinë e pagesave në shtetin tjetër anëtar në SEPA.

Tarifat e përmendura në këtë pikë duhet të jenë të përshtatshme, në përputhje me kostot dhe të dakordësuara midis ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe përdoruesit të shërbimeve të pagesave. Ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet ta informojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për shumën e tarifave shtesë brenda një kohe të arsyeshme, përpara se përdoruesit t'i lindin detyrime për zbatimin e tyre.";

c) kreu V "DISPOZITA TË FUNDIT" rinumërtohet si kreu VI.

3. Ngarkohen ofruesit e shërbimeve të pagesave me zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 janar 2028.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 45, datë 2.9.2026

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË FINANCIARE SHTESË NGA BANKA PROCREDIT SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 23, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 24, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"; të nenit 18, pika 8, të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, të ndryshuar; të pikës 6, të shtojcës 1, të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 36, datë 26.5.2010, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka ProCredit sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësimit në sigurime, në cilësinë e agjentit në sigurime.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës ProCredit sh.a., pas paraqitjes së licencës së dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. 281 (61-2025-2587), datë 15.6.2026, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Elvis Troqe, me atësi Krenar dhe amësi Marsela, i lindur më 3.6.1994, lindur dhe banues në Vlorë, si dhe caktimin e shtetases Marsela Troqe si kujdestare për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të tij.

KËRKESË

Shtetasja Neso Sadiku kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, shpalljen të zhdukur të shtetasit Sadik Sadiku, me atësi Tahir dhe amësi Shane, i datëlindjes 14.5.1938, lindur në Dhermicë/Gumenic, dhe caktimin e saj si kujdestare për administrimin e pasurisë së shtetasit Sadik Sadiku.

KËRKUESE
Neso Sadiku

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 197|Datë: 10.09.2026 14:24:10 +02:00|6689a598-4d71-400f-aaa4-d0f8be4c30a9

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)